

VENDIM
Nr.206, datë 20.12.2010

**PËR MOSDHËNIE LICENCE PERSONIT FIZIK Z.BILBIL HAJDINI PËR
TELEVIZIONIN PRIVAT KABLLOR “TV KABLLOR ALFA HAJDINI”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të mos licencojë për transmetim televiziv privat kabllor, personin fizik Z.Bilbil Hajdini, pasi në dokumentacionin e paraqitur, ekstrakti i Qendrës së Regjistrimit Tregtar, i paraqitur nga subjekti, është marrë në datën 23.2.2010; Të dhënat për kapitalin financiar, sipas deklaratës së ekspertit kontabël të autorizuar janë në pronësi të “Tv kabllor Vjosa” dhe është depozituar në vlerë më të ulët se 10 milionë lekë; Subjekti nuk ka paraqitur organizimin e stafit dhe në projektin teknik nuk ka parashikuar pavarësinë nga rrjeti elektrik. Gjithashtu, subjekti rezulton të jetë në transmetim pa autorizimin, licencimin e KKRT-së.

2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati